



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 118, Datë 24.05.2022

MBI

**NJOHJEN E LICENCËS PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE LËSHUAR
NGA ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR
SUBJEKTIN “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K.
(FUENTE DYNAMICS)”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; “Memorandumin e Mirëkuptimit për njohjen reciproke të licencave për veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike ndërmjet autoriteteve kombëtare rregullatore të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 245, datë 06.12.2021; bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 24.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 562/4-1 prot., datë 17.05.2022, “Mbi njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike nr. ZRRE/LI_72/21, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, ME VENDIMIN V_1400_2021, datë 02.09.2021, për subjektin “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K. (FUENTE DYNAMICS)”, që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K., Dega në Tiranë”.

Konstatoi se:

- Subjekti “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K., Dega Tiranë”, me shkresën e datës 24.03.2022, protokolluar në ERE me nr. 405, datë 24.03.2022, ka paraqitur kërkesën për njohje të licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (licenca për furnizim me shumicë (tregtim), të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin V_1400_2021, datë 02.09.2021.

- Duke qenë se dokumentacioni i depozituar fillimisht nga shoqëria nuk ishte i plotë, ERE i evidentoi shoqërisë këtë fakt me shkresën nr. 405/1 prot., datë 06.04.2022. Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 4005/2 prot., datë 08.04.2022, shoqëria depozitoi të gjithë dokumentacionin e munguar.
- ERE me shkresën nr. 405/3 prot., datë 27.04.2022, i paraqiti Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, kërkesën për informacion në lidhje me vlefshmërinë e kësaj licence dhe në rast se kjo zyrë ka ndërmarrë ndonjë veprim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence. Kjo shkresë u dërgua dhe e skanuar në adresën elektronike zyrtare të ZRRE, info@ero-ks.org, në datën 29.04.2022. ZRRE ka njoftuar se nuk ka filluar dhe as ka ndërmarrë ndonjë veprim apo vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence
- Me shkresën nr. 237/22 prot., datë 11.05.2022, protokolluar në ERE me nr. 405/4 prot., datë 16.05.2022, ZRRE Kosovë ka informuar ERE-n se ka lëshuar licencën për tregtimin e energjisë elektrike me numër ZRRE/LI_72/21, për subjektin juridik “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K. (FUENTE DYNAMICS)”, me afat vlefshmërie nga 02.09.2021, deri më 01 shtator 2026.
- Në kuptim të nenit 4, pika 3, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”, e ndryshuar, është pranuar njohja reciproke e licensave për tregëtimin e energjisë elektrike me kusht që subjekti që aplikon për njohjen e licensës të të dorëzojnë në ERE licencën e përkthyer dhe noterizuar si dhe informacionin e përcaktuar në nenin 9 (1) dhe 9 (2), gërma “c”, të kësaj rregullore.

Subjekti ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 3, të Rregullores së sipërcituar si dhe

- ka kryer pagesën e aplikimit për njohje të licensës për tregtimin e energjisë elektrike.
- Afati i njohjes së licensës do të jetë i njëjtë me afatin e licensës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, për shoqërinë “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K. (FUENTE Dynamics)”, deri më 01.09.2026.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike nr. ZRRE/LI_72/21, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_1400_2021, datë 02.09.2021, për subjektin “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K. (FUENTE Dynamics)”, që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K., Dega në Tiranë”.
2. Njohja e licencës sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi do të jetë e vlefshme deri më 01.09.2026.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.